

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Materiale elektrike 31681410-0, Materiale hidraulike 44115210-4

Vlera e fondit limit: 15 989 371 (pesëmbëdhjetëmilionë e nëntëqindetëdhjetenëntëmijë e treqindeshtatëdhjetenjë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Ky kriter synon të sigurojë që çdo operator ekonomik të konfirmojë paraprakisht, nën përgjegjësi ligjore, përmbushjen e kushteve dhe kërkesave të përgjithshme të parashikuara nga legjislati në fuqi për prokurimin publik. Përmes vetëdeklarimit mundësohet një zhvillim më efikas i procedurës së vlerësimit të ofertave, duke

shmangur ngarkesën administrative të paraqitjes së menjëhershme të dokumentacionit të plotë nga të gjithë ofertuesit, ndërkohë që autoriteti kontraktor ruan të drejtën për të kërkuar dhe verifikuar dokumentacionin provues përkatës në fazat e mëvonshme të procedurës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 OE duhet te paraqese vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/b dhe nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar sa vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/b ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar...”.*

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 35 % e vlerës së fondit limit të kontratës, që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën” nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 35 % e vlerës së fondit limit të kontratës, që prokurohet.

Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është mbi kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

- SSH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH EN ISO 9001:2015 “Sisteme të menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili OE duhet të paraqesë certifikatat ISO të mësipërme.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara

nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatave SSH EN ISO 14001:2015 dhe SSH EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente/të barasvlefshme, është vendosur në funksion të garantimit të cilësisë së mallrave, përmbushjes së standardeve teknike dhe sigurimit të menaxhimit profesional të proceseve të furnizimit në kuadër të objektit të prokurimit.

Kërkesa për certifikatën SSH EN ISO 9001:2015 lidhet drejtpërdrejt me nevojën që operatori ekonomik të garantojë standarde të qëndrueshme cilësie në furnizimin me materiale elektrike dhe hidraulike. Materialet objekt prokurimi ndikojnë drejtpërdrejt në funksionalitetin, sigurinë dhe jetëgjatësinë e instalimeve elektrike dhe hidraulike, ndaj kërkohet që operatori ekonomik të ketë të implementuar sisteme të kontrollit të cilësisë që sigurojnë përputhshmërinë e mallrave me specifikimet teknike dhe standardet në fuqi, kontrollin e proceseve të furnizimit dhe magazinimit, si dhe minimizimin e riskut për furnizim me produkte jo cilësore apo jashtë standardeve. Kjo certifikatë garanton se operatori ekonomik disponon procedura të standardizuara për menaxhimin e cilësisë dhe rrit besueshmërinë në realizimin korrekt të kontratës.

Kërkesa për certifikatën SSH EN ISO 14001:2015 është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në përputhje me praktikën e menaxhimit mjedisor dhe me standardet për mbrojtjen e mjedisit. Furnizimi, transporti dhe magazinimi i materialeve elektrike dhe hidraulike shoqërohen me procese që mund të kenë ndikim mjedisor, ndaj kërkohet që operatori ekonomik të zbatojë politika të kontrollit mjedisor, të minimizojë ndikimin negativ në mjedis, të respektojë legjislacionin mjedisor në fuqi dhe të aplikojë praktika të qëndrueshme gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar. Kjo kërkesë konsiderohet proporcionale dhe e lidhur ngushtë me natyrën dhe rëndësinë e objektit të prokurimit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator duhet të paraqesë certifikatat ISO të mësipërme, pasi secili prej tyre merr përsipër realizimin e një pjese të kontratës dhe duhet të garantojë standarde të njëjta cilësie dhe menaxhimi mjedisor në aktivitetin që do të kryejë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se:

“8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

Kërkesa që operatori ekonomik të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese është vendosur në funksion të garantimit të cilësisë, gjurmueshmërisë dhe përputhshmërisë së mallrave me specifikimet teknike të kërkuara.

Përcaktimi i origjinës së mallit dhe identifikimi i kompanisë prodhuese i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar standardet e prodhimit, besueshmërinë e produkteve dhe përputhjen e tyre me kërkesat teknike dhe ligjore në fuqi. Materialet elektrike dhe hidraulike ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë, funksionalitetin dhe jetëgjatësinë e instalimeve, ndaj është e nevojshme që Autoriteti Kontraktor të ketë informacion të qartë mbi prodhuesin dhe origjinën e produkteve që do të furnizohen.

Kjo kërkesë mundëson gjithashtu verifikimin e autenticitetit të mallrave, shmangien e produkteve jo cilësore ose të paidentifikuara në treg, si dhe krijon mundësinë për kontrollin e dokumentacionit teknik dhe certifikimeve përkatëse të prodhuesit. Në të njëjtën kohë, vetëdeklarimi i origjinës dhe kompanisë prodhuese rrit transparencën dhe përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik gjatë realizimit të kontratës dhe konsiderohet një kërkesë proporcionale, e lidhur ngushtë me natyrën e objektit të prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostër të artikullit nr. 21, 22, 23, 24, 25, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 58 dhe 61 të cilat duhet të jetë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën “Specifikimet Teknike” të DST-së.

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: pranë ish-stadiumit, Himarë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”* dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht*

që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.

Duke qenë se artikujt e kërkuar janë pajisje ndriçimi dhe komponentë elektrikë që përdoren në ambiente të brendshme dhe të jashtme, si dhe në rrjete ndriçimi publik, paraqitja e mostrave konsiderohet e domosdoshme për të mundësuar verifikimin fizik dhe teknik të produkteve të ofertuara, përtej dokumentacionit deklarativ të paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Për artikullin nr. 21 “Llambë LED 20W”, paraqitja e mostrës kërkohet për të verifikuar në mënyrë konkrete fuqinë reale të produktit, temperaturën e ngjyrës 10,000K, cilësinë e ndriçimit, bazën standarde E27 dhe përputhshmërinë me tensionin e kërkuar të punës 220–240V AC. Përmes mostrës Autoriteti Kontraktor vlerëson cilësinë e materialit të trupit të llambës, disipimin termik, intensitetin real të ndriçimit dhe autenticitetin e markimit CE, pasi këta elementë ndikojnë drejtpërdrejt në jetëgjatësinë, sigurinë elektrike dhe eficiencën energjetike të produktit gjatë përdorimit.

Për artikullin nr. 22 “Llambë LED 30W”, paraqitja e mostrës është e nevojshme për të verifikuar fluksin real ndriçues prej 3000 lumen, indeksin e interpretimit të ngjyrave CRI >85, klasën energjetike A dhe përputhshmërinë e produktit me parametrat e deklaruar teknikë. Përmes mostrës bëhet i mundur kontrolli i cilësisë së ndriçimit, uniformitetit të shpërndarjes së dritës, konsumit energjetik dhe cilësisë konstruktive të produktit, me qëllim shmangien e furnizimit me produkte nën standard ose me performancë më të ulët nga ajo e kërkuar.

Për artikullin nr. 23 “Ndriçues LED për tavan gipsi 19W”, mostra kërkohet për të verifikuar përmasat reale të produktit, diametrin e jashtëm dhe të brendshëm, mënyrën e montimit në tavan gipsi, cilësinë e ndriçimit dhe përputhshmërinë me parametrat teknikë të kërkuar. Duke qenë se ky produkt përdoret për instalime të brendshme dhe kërkon përshtatje fizike me hapësirat ekzistuese të montimit, verifikimi fizik i mostrës është i domosdoshëm për të shmangur problematika gjatë instalimit dhe përdorimit.

Për artikullin nr. 24 “Ndriçues LED për tavan gipsi 24W”, paraqitja e mostrës kërkohet për të verifikuar fuqinë ndriçuese, temperaturën e ngjyrës 4000K, përmasat reale të produktit dhe cilësinë e materialeve përbërëse. Mostra i shërben Autoritetit Kontraktor për të kontrolluar mënyrën e montimit, cilësinë e përfundimit estetik dhe performancën reale të ndriçimit në raport me specifikimet teknike të kërkuara.

Për artikullin nr. 25 “Ndriçues LED i jashtëm për tavan gipsi 60x60”, paraqitja e mostrës është e nevojshme për të verifikuar cilësinë e panelit LED, përmasat reale 60x60 cm, fuqinë ndriçuese, temperaturën e ngjyrës 6400K dhe jetëgjatësinë minimale të deklaruar në ambalazh. Përmes mostrës verifikohet gjithashtu cilësia e konstruksionit të panelit, uniformiteti i ndriçimit dhe autenticiteti i markimit CE, duke qenë se këto produkte përdoren në ambiente pune ku kërkohet ndriçim i qëndrueshëm dhe eficient.

Për artikullin nr. 44 “Ndriçues rrugor LED 50W Ø40”, paraqitja e mostrës konsiderohet thelbësore për shkak të funksionit që produkti ka në ndriçimin publik dhe sigurinë rrugore. Përmes mostrës Autoriteti Kontraktor verifikon përputhshmërinë e grykës së montimit Ø40 mm, cilësinë e materialit të trupit, shkallën e mbrojtjes IP66 ndaj ujit dhe pluhurave, eficiencën energjetike, fluksin ndriçues dhe cilësinë reale të ndriçimit. Verifikimi fizik i produktit është i domosdoshëm

për të garantuar rezistencën ndaj kushteve atmosferike dhe performancën afatgjatë në ambiente të jashtme.

Për artikullin nr. 45 “Llambë LED 12W”, paraqitja e mostrës kërkohet për të verifikuar bazën standarde E27, temperaturën e ngjyrës 8000K, klasën energjetike A dhe cilësinë e përgjithshme të produktit. Mostra i shërben Autoritetit Kontraktor për të kontrolluar performancën reale të ndriçimit dhe përputhshmërinë me parametrat teknikë të deklaruar nga operatori ekonomik.

Për artikullin nr. 46 “Llambë LED 15W”, paraqitja e mostrës është e nevojshme për të verifikuar parametrat teknikë të deklaruar, cilësinë e ndërtimit, konsumimin energjetik dhe jetëgjatësinë e produktit. Përmes mostrës bëhet i mundur kontrolli i cilësisë së ndriçimit dhe sigurisë elektrike të produktit që do të furnizohet.

Për artikullin nr. 47 “Prozhektor LED 200W”, paraqitja e mostrës kërkohet për shkak të fuqisë së lartë ndriçuese dhe përdorimit të produktit në ambiente të jashtme. Mostra mundëson verifikimin e fluksit real ndriçues prej 22,500 lumen, shkallës së mbrojtjes IP65, cilësisë së materialeve përbërëse, sistemit të disipimit të nxehtësisë, përmasave reale dhe cilësisë së ndriçimit. Duke qenë se produkti përdoret në kushte të jashtme dhe ka rol të rëndësishëm në ndriçim dhe siguri, verifikimi fizik konsiderohet i domosdoshëm.

Për artikullin nr. 48 “Prozhektor LED 100W”, mostra kërkohet për të verifikuar performancën reale të ndriçimit, cilësinë konstruktive, temperaturën e ngjyrës 2700K, shkallën e mbrojtjes IP65 dhe përputhshmërinë me parametrat teknikë të kërkuar. Përmes mostrës Autoriteti Kontraktor kontrollon që produkti të jetë i përshtatshëm për përdorim në ambiente të jashtme dhe të garantojë jetëgjatësi dhe siguri gjatë funksionimit.

Për artikullin nr. 49 “Llambë LED 11W E27”, paraqitja e mostrës është e nevojshme për të verifikuar bazën standarde E27, temperaturën e ngjyrës 2700K, cilësinë e ndriçimit, parametrat e funksionimit dhe autenticitetin e markimit CE. Përmes verifikimit fizik të mostrës sigurohet që produkti i ofertuar përmbush standardet minimale të cilësisë dhe performancës të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa për paraqitjen e mostrës për artikullin nr. 58 “Mishelator lavamani” është vendosur duke qenë se ky produkt përdoret në instalime sanitare me përdorim të vazhdueshëm, është e nevojshme që Autoriteti Kontraktor të verifikojë materialin përbërës të produktit, cilësinë e kromimit, rezistencën ndaj korrozionit dhe lagështisë, si dhe funksionimin e mekanizmit të komandimit të ujit të ftohtë dhe të ngrohtë. Përmes mostrës bëhet i mundur kontrolli i cilësisë konstruktive, peshës së produktit, përfundimit estetik dhe përputhshmërisë me standardin CE, me qëllim shmangien e furnizimit me produkte jo cilësore ose nën standard, të cilat mund të sjellin defekte gjatë përdorimit dhe kosto shtesë mirëmbajtjeje.

Kërkesa për paraqitjen e mostrës për artikullin nr. 61 “Pompa uji 1.1 kW” është vendosur për shkak të rëndësisë funksionale dhe teknike që ky produkt ka në sistemet e furnizimit me ujë. Përmes mostrës, Autoriteti Kontraktor verifikon cilësinë e trupit metalik, parametrat konstruktivë, elementët mbrojtës termikë, cilësinë e përpunimit dhe përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara. Duke qenë se pompa e ujit është pajisje elektromekanike që punon në kushte presioni dhe ngarkese të vazhdueshme, paraqitja e mostrës konsiderohet e domosdoshme për të garantuar që produkti i ofertuar plotëson standardet e sigurisë, rezistencës ndaj korrozionit dhe performancës funksionale.

Kërkesa për paraqitjen e mostrave i shërben Autoritetit Kontraktor për të kryer një vlerësim sa më të saktë teknik dhe cilësor të mallrave të ofertuara, për të garantuar përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike dhe për të shmangur furnizimin me produkte jo cilësore, të paçertifikuara ose që nuk përmbushin standardet e kërkuara të sigurisë dhe performancës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

1. Shtylla metalike 6.8 m. Shtylla metalike e galvanizuar me lartësi 6.8 m është kërkuar për realizimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të ndriçimit publik. Lartësia 6.8 m garanton shpërndarje optimale të fluksit ndriçues në rrugë dhe hapësira publike. Materiali çelik konstruktiv S235 ose ekuivalent siguron rezistencë të lartë mekanike ndaj ngarkesave statike dhe dinamike. Galvanizimi në të nxehtë është kërkuar për mbrojtje ndaj korrozionit dhe oksidimit, duke marrë në konsideratë kushtet atmosferike dhe praninë e lagështisë e kripës në zonat bregdetare. Pajisja me pllakë bazamenti dhe bulona ankorimi është e domosdoshme për stabilitet dhe siguri strukturore gjatë montimit dhe përdorimit.
2. Krahu për kokë ndriçimi. Krahu metalik i galvanizuar përdoret për montimin e ndriçuesve rrugorë në shtylla metalike. Gjatësia 1–1.5 m është përcaktuar për të siguruar pozicionim të përshtatshëm të ndriçuesit dhe shpërndarje të njëtrajtshme të dritës. Materiali i galvanizuar garanton rezistencë ndaj korrozionit dhe kushteve atmosferike, duke rritur jetëgjatësinë e pajisjes dhe minimizuar kostot e mirëmbajtjes.
3. Morseta. Morsetat lidhëse elektrike janë kërkuar për realizimin e lidhjeve të sigurta elektrike në instalime dhe rrjete ndriçimi. Materiali përçues cilësor siguron kalueshmëri të mirë elektrike dhe shmang nxehjen e kontakteve. Izolimi rezistent ndaj temperaturës dhe lagështisë është i nevojshëm për të garantuar siguri elektrike dhe jetëgjatësi në kushte të ndryshme ambientale.
4. Kabëll ABC 2x16 mm². Kablli ajror vetëmbajtës ABC 2x16 mm² është specifikuar për furnizim elektrik në rrjete ajrore me tension të ulët. Përçuesi alumini ofron peshë më të ulët dhe rezistencë të mirë elektrike. Izolimi XLPE siguron rezistencë termike, mekanike dhe mbrojtje ndaj rrezeve UV. Seksioni 16 mm² është përcaktuar në funksion të ngarkesës elektrike dhe distancave të shpërndarjes.
5. Kabëll ABC 4x16 mm². Kablli ABC 4x16 mm² përdoret në rrjete shpërndarjeje trefazore. Konfigurimi 4x16 mm² garanton furnizim të sigurt dhe të qëndrueshëm për ndriçim publik dhe instalime energjetike. Izolimi XLPE dhe rezistenca ndaj lagështisë e korrozionit janë kërkuar për përdorim afatgjatë në ambiente të jashtme.
6. Tirantues 4x16 mm². Tirantuesit për kablllo ABC 4x16 mm² janë të nevojshëm për tensionimin dhe ankorimin korrekt të kablllove ajrore. Materiali çelik i galvanizuar ose aliazh alumini garanton rezistencë të lartë mekanike dhe mbrojtje ndaj korrozionit, duke siguruar stabilitet të rrjetit elektrik.
7. Tirantues 2x16 mm². Ky artikull është kërkuar për fiksimin dhe tensionimin e kablllove ABC 2x16 mm². Karakteristikat mekanike dhe mbrojtja ndaj korrozionit janë të nevojshme për garantimin e sigurisë dhe jetëgjatësisë së rrjetit.
8. Konektor 16/95 (abonenti). Konektori shpues izolimi është kërkuar për lidhje të shpejta dhe të sigurta të kablllove pa dëmtim të përçuesit. Diapazoni 16–95 mm² mundëson përdorim në

konfigurime të ndryshme rrjeti. Materiali izolues rezistent ndaj UV dhe kontaktet antikorrozive garantojnë funksionim afatgjatë në ambiente të jashtme.

9. Kabëll CU 2x1.5 mm². Kablli bakri 2x1.5 mm² përdoret për instalime elektrike të brendshme dhe furnizim ndriçimi. Përçuesi bakër siguron përçueshmëri të lartë elektrike dhe siguri në përdorim. Izolimi PVC garanton mbrojtje mekanike dhe elektrike sipas standardeve të instalimeve civile.

10. Kabëll CU 3x2.5 mm². Ky kabëll është kërkuar për furnizim prizash dhe pajisjesh elektrike me ngarkesë mesatare. Seksioni 2.5 mm² siguron kalim të sigurt të rrymës pa mbinxehje. Izolimi rezistent ndaj temperaturës dhe konsumit mekanik garanton përdorim afatgjatë.

11. Kabëll CU 4x4 mm². Kablli përdoret në instalime energjetike dhe shpërndarje të energjisë elektrike. Seksioni 4 mm² është përcaktuar për ngarkesa më të larta elektrike dhe për furnizim trefazor. Izolimi PVC ose XLPE garanton mbrojtje termike dhe elektrike.

12. Kabëll CU 3x6 mm². Kablli 3x6 mm² është kërkuar për furnizim të pajisjeve me konsum më të lartë energjie dhe instalime të fuqisë. Izolimi PVC/XLPE siguron rezistencë ndaj lagështisë dhe temperaturave të larta.

13. Kabëll CU 4x6 mm². Ky kabëll përdoret për shpërndarje energjie në rrjete trefazore. Seksioni dhe izolimi janë përcaktuar për të garantuar siguri, qëndrueshmëri dhe humbje minimale energjie gjatë transmetimit.

14. Kabëll CU 4x10 mm². Kablli 4x10 mm² është kërkuar për furnizime kryesore energjetike dhe ngarkesa të larta. Rezistenca termike dhe mekanike është e domosdoshme për sigurinë e instalimeve dhe shmangien e mbinxehjes.

15. Kasetë metalike 30x40 cm. Kasete metalike përdoret për montimin dhe mbrojtjen e pajisjeve elektrike. Përmasat 30x40 cm janë përcaktuar për të akomoduar pajisje komandimi dhe mbrojtjeje. Shkalla IP54 garanton mbrojtje ndaj pluhurit dhe spërkatjeve të ujit.

16. Kasetë metalike 20x30 cm. Kasete përdoret për instalime elektrike të dimensioneve më të vogla. Materiali rezistent ndaj korrozionit dhe mbrojtja IP54 garantojnë përdorim të sigurt në ambiente të brendshme dhe të jashtme.

17. Shinë për kasete metalike. Shina DIN 35 mm është standard ndërkombëtar për montimin e automatëve dhe pajisjeve elektrike në kasete. Materiali i galvanizuar garanton rezistencë mekanike dhe ndaj korrozionit.

18. Izolant. Izolanti prej porcelani ose materiali polimerik përdoret për mbështetje dhe izolim elektrik në rrjete ajrore. Rezistenca ndaj tensionit elektrik dhe kushteve atmosferike është e domosdoshme për sigurinë e rrjetit.

19. Klema të ndryshme. Klemat përdoren për realizimin e lidhjeve elektrike të sigurta dhe të qëndrueshme. Materiali përçues cilësor dhe izolimi rezistent ndaj lagështisë shmangin humbjet elektrike dhe dëmtimet nga korrozioni.

20. Ndriçues rrugor LED 100W. Ndriçuesi LED 100W është kërkuar për ndriçim publik me efikasitet të lartë energjetik. Shkalla IP65 garanton mbrojtje ndaj pluhurit dhe ujit, ndërsa efikasiteti ≥ 120 lm/W siguron ndriçim optimal me konsum të reduktuar energjie. Jetëgjatësia $\geq 50,000$ orë ul kostot e mirëmbajtjes dhe zëvendësimit.

21. Llambë LED 20W. Llamba LED 20W është specifikuar për ndriçim ekonomik dhe jetëgjatë. Temperatura e ngjyrës 10,000K siguron ndriçim të bardhë intensiv të përshtatshëm për ambiente

pune dhe shërbime publike. Certifikimi CE garanton siguri dhe përputhshmëri me standardet evropiane.

22. Llambë LED 30W. Llamba LED 30W është kërkuar për ambiente që kërkojnë fluks ndriçimi më të lartë. Parametrat si 3000 lumen dhe CRI >85 garantojnë cilësi të mirë ndriçimi dhe interpretim korrekt të ngjyrave.

23. Ndriçues LED për tavan gipsi 19W. Ndriçuesi LED për tavan gipsi është specifikuar për ambiente administrative dhe publike. Fuqia 19W dhe fluksi 2000 lumen sigurojnë ndriçim të mjaftueshëm me konsum të ulët energjie. Jetëgjatësia 50,000 orë garanton mirëmbajtje minimale.

24. Ndriçues LED për tavan gipsi 24W. Ky ndriçues përdoret në ambiente me nevojë për intensitet më të lartë ndriçimi. Temperatura 4000K krijon ndriçim natyral dhe komod për përdorim të përditshëm.

25. Ndriçues LED i jashtëm për tavan gipsi 60x60. Paneli LED 60x60 cm është kërkuar për ndriçim uniform në zyra dhe ambiente institucionale. Fuqia 36W siguron raport optimal konsum/ndriçim dhe jetëgjatësia minimale garanton efikasitet ekonomik gjatë përdorimit.

26. Automat 1P 16A. Automati njëfazor 16A përdoret për mbrojtjen e qarqeve elektrike nga mbingarkesa dhe qarku i shkurtër. Karakteristika tip C është e përshtatshme për përdorim në instalime civile dhe ndriçim.

27. Automat 1P 20A. Ky automat është specifikuar për qarqe me konsum më të lartë energjie. Standardi IEC/EN 60898 garanton siguri dhe performancë sipas normave ndërkombëtare.

28. Automat 1P 25A. Automati 25A është kërkuar për mbrojtjen e pajisjeve dhe qarqeve me ngarkesa të mesme dhe të larta. Mbrojtja termike dhe magnetike siguron ndërprerje të menjëhershme në rast anomalie.

29. Automat 1P 32A. Automati 32A përdoret për qarqe me ngarkesa të larta elektrike dhe pajisje fuqie. Kapaciteti i lartë ndërprerës garanton siguri operative.

30. Automat 3F+N 16A. Automati trefazor me neutral përdoret për mbrojtjen e rrjeteve trefazore në instalime industriale dhe publike. Siguron mbrojtje të plotë ndaj mbingarkesës dhe qarkut të shkurtër.

31–35. Automatë dhe lëshues trefazorë. Këta artikuj janë kërkuar për mbrojtjen e instalimeve trefazore me ngarkesa të ndryshme operative. Kapacitetet 20A–63A janë përcaktuar sipas nevojave të shpërndarjes së energjisë në objektet publike dhe ndriçimin rrugor. Pajisjet diferenciale mbrojnë personelin dhe instalimet nga rrjedhjet elektrike.

36. Fotoelement. Fotoelementi përdoret për automatizimin e ndezjes dhe fikjes së ndriçimit publik. Sensori i dritës redukton konsumin energjetik dhe eliminon nevojën për komandim manual.

37. Portollambë 10A. Portollamba është kërkuar për montimin e sigurt të llambave elektrike. Materiali izolues rezistent ndaj temperaturës shmang deformimet dhe rrezikun e zjarrit.

38–41. Priza, çelësa dhe aksesorë. Këta artikuj janë specifikuar për realizimin e instalimeve elektrike të sigurta dhe funksionale në ambiente administrative dhe publike. Materialet vetëshuarëse dhe rezistente ndaj temperaturës rrisin sigurinë në përdorim.

42. Elektrode tokëzimi. Elektroda e tokëzimit është element sigurie për shkarkimin e rrymave difektoze në tokë. Materiali çelik i galvanizuar ose bakri siguron përçueshmëri të lartë dhe rezistencë ndaj korrozionit.

43–49. Ndiriçues dhe llamba LED. Këto produkte janë specifikuar për të garantuar efikasitet energjetik, jetëgjatësi të lartë dhe cilësi ndiriçimi në rrugë, ambiente publike dhe institucione. Shkallët IP65/IP66 dhe certifikimi CE janë kërkuar për siguri dhe rezistencë ndaj kushteve atmosferike.

50–52. Materiale ndihmëse hidraulike. Defkeni, silikoni antityk dhe fijet e linit janë kërkuar për realizimin e izolimeve dhe mbylljeve hermetike në instalime hidraulike. Rezistenca ndaj temperaturës dhe lagështisë garanton shmangien e rrjedhjeve.

53–68. Pajisje sanitare dhe hidraulike. Kasetat WC, fleksiblat inox, rubinetat, mikshelatorët, shkarkuesit, grupet e lavamanëve, WC-të dhe aksesoret përkatës janë specifikuar me materiale rezistente ndaj korrozionit dhe lagështisë për të garantuar higjienë, jetëgjatësi dhe funksionim korrekt në ambiente publike. Standardi CE garanton përputhje me normat evropiane të sigurisë dhe cilësisë.

61–64. Pompa, bojlerë dhe depozita. Këto pajisje janë kërkuar për garantimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë dhe funksionimin e sistemeve hidraulike. Materialet rezistente ndaj korrozionit dhe izolimi termik janë të nevojshme për përdorim afatgjatë.

69. Zile për shkolla. Zilja elektrike është specifikuar për përdorim në ambiente shkollore dhe administrative. Niveli i zërit 75 dB siguron dëgjueshmëri të mjaftueshme pa krijuar shqetësime akustike.

70–121. Tuba, bashkues, brryla, valvula dhe aksesore hidraulikë. Këta artikuj janë kërkuar për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimeve dhe sistemeve hidraulike. Materialet HDPE, PPR, PVC, bronzi dhe çeliku i galvanizuar janë zgjedhur për shkak të rezistencës ndaj presionit, korrozionit, deformimeve mekanike dhe kushteve atmosferike. Klasat PN16 dhe SN8 janë përcaktuar për të garantuar siguri në punë dhe jetëgjatësi të rrjeteve.

122. Tub zjarrefikës 2”–3”, 8 bar, 30 m. Tubacioni zjarrefikës është kërkuar për përdorim në raste emergjente dhe ndërhyrje zjarrefikëse. Rezistenca ndaj presionit 8 bar dhe konsumit mekanik garanton përdorim të sigurt dhe efikas.

123. PVC kuti. Kutia PVC përdoret për mbrojtjen e lidhjeve elektrike ose hidraulike. Materiali plastik rezistent ndaj lagështisë dhe goditjeve garanton mbrojtje dhe siguri gjatë përdorimit.

NJËSIA E PROKURIMIT